

Enti Rregullator i Ujit i Shqipërisë

# Analiza vjetore 2017



## 1. Menaxhimi burimeve dhe mbështetja e veprimtarisë së njësisë

Garantimi i burimeve të financimit dhe mbështetja e veprimtarisë së ERRU, mbetet në qendër të vëmendjes së punës së sektorëve të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse.

Në vijimësi veprimtaria e Rregullatorit gjatë vitit, është karakterizuar nga një sërë aktiviteteve, veprimtarish e takimesh në terren me operatorët dhe drejtuesit e pushteteve vendore, këto të lidhura ngushtë me ecurinë e reformës administrative në vend si dhe me përmbushjen e realizimin e objektivave vjetore të institucionit, dhe problematika të ndryshme të rregullimit në sektorin UK.

Janë në përgjegjësinë e dy sektorëve të Drejtorisë menaxhimi i burimeve njerëzore, mirë administrimi i vlerave materiale e monetare të njësisë, administrimi i dokumentacionit zyrtar të njësisë, mbështetja e plotë logjistike e KKRR dhe stafit për realizimin detyrave e objektivave vjetorë të ERRU, arkëtimi i pagesave rregullatore nga operatorët si dhe përdorimi i tyre me efikasitet e në përputhje me planin e shpenzimeve operative dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Gjatë këtij viti është punuar për plotësimin e strukturës së re organizative të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me vendimin nr. 34/2016, datë 28.04.2016, "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Entit Rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura".

Janë ndjekur procedurat e përcaktuara për plotësimin e vendeve të lira të punës në përputhje me përcaktimet në "Rregulloren për rekrutimin, vlerësimin dhe ndërprerjen e marrëdhënieve të punës në ERRU".

Në përfundim të procedurave përkatëse me vendimmarrje të KKRR, kanë filluar marrëdhëniet e punës 4 nëpunës të rinj, tre prej të cilëve specialistë, në Drejtorinë tekniko ekonomike dhe në Drejtorinë Juridike si dhe 1 Sekretare e KKRR dhe Kryetarit. Të tre specialistë e rekrutuar kanë përfunduar me sukses periudhën e provës, ndërsa Sekretaria vijon periudhën 3 mujore të provës.

Në përputhje me Rregulloren për rekrutimin, vlerësimin dhe ndërprerjen e marrëdhënieve të punës në ERRU" gjatë muajit nëntor DTE dhe DSHM kryhen fazën e parë të vlerësimit të performancës së nëpunësve të tyre, për periudhën nëntor -2016 deri më tetor 2017.

Në përmbushje të detyrave funksionale sektori burimeve njerëzore e financiare ka ndjekur rregullisht monitorimin e vazhdueshëm të arkëtimeve të pagesave rregullatore, realizimin e planit të shpenzimeve operative, administrimin e aktiveve e vlerave materiale të njësisë. Gjithashtu sektori i shërbimeve mbështetëse ka garantuar mbështetjen e plotë logjistike e KKRR dhe stafit për realizimin detyrave e objektivave vjetorë të ERRU përmes sigurimit rregullisht të shërbimeve të nevojshme e domosdoshme për funksionimin normal të aktivitetit rutinë të punës.

Analiza vjetore 2017 është konceptuar mbështetur në analizën e treguesve financiarë në fund të vitit e problematikat e ndryshme që paraqiten lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet.

## 1.1 Të Ardhurat

Burimet e financimit të aktivitetit e veprimtarisë së ERRU, sikurse përcaktohet në ligjin nr. 8102, datë 28.03.1996. "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", janë pagesat e rregullimit, të detyrueshme për operatorët që operojnë në sektorin UK. Ato përbëhen nga pagesat rregullatore vjetore dhe pagesat për licencime të vendosura nga vetë Rregullatori.

Enti Rregullator i Ujit në përputhje me ligjin, ka nënshkruar kontrata me operatorët për aplikimin e tarifave të miratuara, ku është përcaktuar pagesa rregullatore vjetore dhe afatet e likuidimit. Detyrimi vjetor i pagesave rregullatore për vitin 2017, mbështetur në kontratat përkatëse me shoqëritë, është në shumën 46,529 mijë lekë. Kjo vlerë përlllogaritet vetëm nga pagesat rregullatore vjetore të shoqërive që operojnë me tarifa të miratuara nga Rregullatori, pa përfshirë shoqëritë që nuk kanë tarifa të miratuara.

Gjatë vitit 2017, të ardhurat e realizuara janë në shumën 49,706 mijë lekë, prej të cilave nga pagesat rregullatore 48,290.5 mijë lekë, nga pagesat për licencime 1,200 mijë lekë dhe të tjera 155.5 mijë lekë.

Të ardhurat e periudhës raportuese të detajuara sipas burimeve dhe katër mujorëve, paraqiten në Tabelën e mëposhtme:

**Tabela 2.** Të ardhurat e realizuara në vitin 2017 sipas periudhave.

Në 000/ lekë

Burimi i të ardhurave	Realizim Janar - Prill	Realizim Maj - Gusht	Realizim Shtator- dhjetor
Pagesa rregullatore	8 901	10 528	28 861.5
Pagesa licencimi	410	560	290
Të tjera		155.5	
<b>Shuma</b>	<b>9 311</b>	<b>11 243.5</b>	<b>29 151.5</b>

Të ardhurat e realizuara në vitin 2017, garantuan tërësisht mbështetjen financiare për ushtrimin e aktivitetit vjetor të Entit duke mbuluar tërësisht shpenzimet vjetore të tij.

Në periudhën shtator - dhjetor të ardhurat nga pagesat rregullatore janë rritur ndjeshëm, thuajse të barabarta me të ardhurat e dy katër mujorëve të parë të vitit.

Në mbyllje të vitit 2017, gjendja e mjeteve financiare të disponueshme në llogarinë bankare të Entit, garanton plotësisht fondin e parashikuar nga KKRR për vitin 2018, i cili pritet të miratohet së shpejti nga Këshilli i Ministrave.

Si rezultat, pas miratimit nga KM të planit të vitit 2018, në muajin janar do të kalohet në buxhetin e shtetit teprica që mbetet, si diferencë e gjendjes në llogarinë bankare në fund të vitit 2017 me planin e miratuar të shpenzimeve për vitin 2018.

### 1.1.1 Pagesat Rregullatore

Detyrimi i kontraktuar i pagesave rregullatore vjetore, të operatorëve që operojnë me tarifa të miratuara nga Enti, përlllogaritet në shumën **46,527** mijë lekë.

Arkëtimet nga pagesat rregullatore të këtij viti, krahasuar me ato të vitit pararendës kanë rënë me 1 390 mijë lekë.

Pavarësisht se vlera e arkëtimeve të realizuara nga pagesat rregullatore gjatë vitit është më e madhe se detyrimi kontraktuar vjetor, nga 48 290 mijë lekë të arkëtuara, vetëm 11 760 mijë lekë janë pagesa për llogari të detyrimeve të vitit 2017, shuma 36 530 mijë lekë përlllogaritet si shlyerje e detyrimeve të prapambetura të viteve të mëparshme. Në mbyllje të vitit detyrimet e pashlyera të operatorëve rezultojnë në shumën 86 639 mijë lekë. Pagesat rregullatore të pashlyera ndër vite, janë shumë të larta e prej disa vitesh përbëjnë një problem që nuk po gjen zgjidhje.

Më poshtë paraqiten likuidimet e pagesave rregullatore në vite.

Likuidimi pagesave rregullatore ndër vitet 2012- 2017.

Viti	Likuiduar
2012	37 865
2013	20 405
2014	50 127
2015	39 319
2016	50 380
2017	49 706

Në vijimësi KKRR ka treguar kujdes të veçantë në përcaktimin e pagesave rregullatore vjetore në përpjesëtim të drejtë me të ardhurat e operatorëve që operojnë në sektorin UK si dhe të mjaftueshme për përballimin e shpenzimeve operative vjetore të ERRU. Aktualisht pagesat rregullatore variojnë nga 06-08 % të të ardhurave vjetore të parashikuara të operatorëve.

Pavarësisht këtij fakti, prej disa vitesh pagesat rregullatore të pashlyera, janë shumë të larta e janë kthyer në shqetësim pasi nuk po gjejnë zgjidhje. Në drejtim të likuidimit të pagesave rregullatore, operatorët nuk janë treguar korrekt me rregullatorin për përmbushjen e detyrimeve kontraktuale.

Edhe në rastet kur operatorët kanë marrë shërbimet e ofruara prej Entit, kjo kundrejt angazhimit të tyre për shlyerjen e detyrimeve, më pas ata nuk i kanë likuiduar detyrimet. Në të kundërt, duke mos ju ofruar shërbimet pa likuiduar detyrimet, si në rastin e Sha UK Berat Kuçovë dhe Sha U Gramsh, likuidimet janë kryer në total.

Me pagesa rregullatore të shlyera tërësisht dhe pa asnjë detyrim, në mbyllje të vitit rezultojnë vetëm 11 shoqëri e konkretisht Berat- Kuçovë, Bulqizë, Delvinë, Kolonjë, Gjirokastër, Gramsh, Lezhë, Korçë, Sarandë, Shkodër dhe Vlorë.

Në mbyllje të vitit, nga 32 shoqëri që rezultojnë me detyrime të pashlyera, vetëm 5 prej tyre detyrohen për shumën 70 852 477 lekë, vlerë që përlogaritet në masën 82 % të detyrimit të përgjithshëm të pashlyer të gjithë operatorëve.

Më poshtë paraqiten detyrimet e këtyre pesë shoqërive deri më 31.12.2017, pagesa rregullatore vjetore si dhe mbulimi i kostove O & M me të dhënat e vitit 2016.

<i>Shoqëria</i>	<i>Detyrimi në lekë 31.12.2017</i>	<i>Pagesa rregullatore vjetore</i>	<i>Mbulimi i kostove O &amp; M në %</i>
• Sha UK Durrës	7 382 207	6 182 000	88.44
• Sha UK Fier	10 078 670	2 776 000	126.85
• Sha UK Kavajë	5 311 600	539 000	63
• Sha UK Pogradec	3 220 000	805 000	110
• Sha UK Tiranë	44 860 000	19 320 000	157

Mbulimi i kostove O&M si dhe të dhënat e bilanceve të këtyre shoqërive tregojnë se financat e tyre i kanë të gjitha mundësitë të likuidojnë pagesën rregullatore, ajo duket e vështirë dhe kthehet në barrë për shoqërinë, kur nuk likuidohet rregullisht çdo vit, por mbartet vit pas viti.

Aktualisht në mbyllje të vitit rezultojnë 18 shoqëri të cilat nuk operojnë me tarifa të miratuara nga Enti e për rrjedhojë nuk kanë kontrata si dhe pagesë rregullatore. Konkretisht këta operatorë janë: Sha UK Belsh, Sha UK Cërrik, Sha U Divjakë, Sha U Fushë Arrëz, Sha U Has, Sha UK Kukës, Sha U Këlcyrë, Sha U Mallakastër, Sha U Libohovë, Sha UK Kamzë, Sha UK Patos, Sha U Pustec, Sha U Malësi i madhe, Sha U Vore, Sha U Himarë, Sha U Tropojë, Sha U Vau i Dejës, Sha U Roskovec.

Gjatë këtij viti janë shfaqur problematika edhe në kuadër të riorganizimit të operatorëve UK në përputhje me reformën administrative. Deri tani në asnjë rast ekspertët kontabël, të ngarkuar për ndarjen e aseteve dhe detyrimeve të operatorëve që po riorganizohen, nuk janë shprehur në lidhje me detyrimet e pagesave rregullatore të këtyre subjekteve, duke na krijuar vështirësi në ndarjen e detyrimeve të kontraktuara.

Në mbyllje të vitit 2017, gjendja e detyrimeve të pashlyera rezulton vetëm 1.7 milion lekë më e vogël se ajo e vitit 2016, në vlerën 86 639 mijë lekë.

Sa më sipër, me qëllim rritjen e nivelit të arkëtimit të pagesave rregullatore nevojitet trajtimi i tyre me operatorët debitorë, për nënshkrimin e akt marrëveshjeve, përcaktimin e afateve për likuidimin e detyrimeve, nënshkrimin e akteve të rakordimit me çdo operator dhe sistemin e detyrimeve të operatorëve të suprimuar e të krijuar rishtazi.

### 1.1.2 Pagesat për Licencimet

Pagesat e licencimeve për vitin 2017, arkëtuar nga operatorët që kanë aplikuar për licencim janë në shumën 1 260 000 lekë, prej të cilave 290 000 lekë janë arkëtime të katër mujorit të tretë.

### 1.1.3 Pagesa të tjera

Si pagesa të tjera evidentohet shuma 155 550 leke, arkëtuar si rimbursim nga Banka Botërore për pjesëmarrje në veprimtari ndërkombëtare dhe detyrime të tjera.


## 1.2 Shpenzimet buxhetore

Plani vjetor i shpenzimeve operative të Entit, propozohet nga ai vetë dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr, 8102, datë 28.03.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë e largimit e përpunimit të ujërave të ndotura".

Plani vjetor i shpenzimeve operative për vitin 2017, është miratuar me VKM nr. 939, datë 28.12.2016, "Për miratimin e planit të shpenzimeve, për vitin 2017, të Entit rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura".

Në total plani i miratuar është në shumën 47, 323,000 lekë dhe i detajuar në katër zërat kryesorë Paga, Sigurime shoqërore e shëndetësore, Shërbime e furniturë dhe Investime, në raporte që paraqiten në figurën më poshtë:

**Struktura e planit të shpenzimeve operative të vitit 2017**



KKRR me Vendimin nr. 1, datë 13.01.2017 ka detajuar e planit vjetor miratuar nga Këshilli Ministrave në artikuj të shpenzimeve në përputhje me nevojat e domosdoshme për të garantuar mbështetjen logjistike për përmbushjen e objektivave vjetorë të Entit, zhvillimin e veprimtarive të parashikuara dhe funksionimin normal të veprimtarisë së përditshëm.

Në planin vjetor të Entit, shpenzimet për personelin (paga + sigurime shoqërore) përbëjnë 75% të totalit të planit vjetor të shpenzimeve dhe 25 % janë shërbime e furniturë dhe investime.


Shpenzimet buxhetore të kryera për ushtrimin e aktivitetit të veprimtarisë vjetore të Entit gjatë vitit 2017, janë në shumën 34,761 mijë lekë, ose 73 % të fondit të planifikuar të shpenzimeve operative. Realizimi paraqitet në përqindje të ulët, kryesisht nga influenza e mosrealizimeve në fondet e parashikuara në zërat paga e sigurime shoqërore dhe shërbime e furniturë.

Shpenzimet e kryera të detajuara sipas zërave paraqiten si më poshtë:

- 24,227 mijë lekë, shpenzime për pagat e punonjësve.
- 3,002 mijë lekë, shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore.
- 7,259 mijë lekë, shpenzime për shërbime e furniturë.
- 274 mijë lekë, shpenzime për investime.

Fondet e planifikuara janë shpenzuar në përputhje me strukturën e tyre si dhe në zbatim të akteve ligjore e nënligjore në fuqi për trajtimin me paga e shpërblime të punonjësve, për blerjet e mallrave e shërbimeve të ndryshme të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit vjetor të Entit. Procedurat për blerjen e mallrave dhe shërbimeve të ndryshme janë realizuar nga komisioni përkatës në përputhje e në zbatim të plotë me ligjin “Për prokurimet publike” dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi. Po kështu është ndjekur në vazhdimësi edhe përmbushja e detyrimeve kontraktuale për mallrat dhe shërbimet e ndryshme duke kryer njëkohësisht edhe pagesat përkatëse. Në mbyllje të vitit Rregullatori nuk ka shërbime apo detyrime të tjera të pashlyera ndaj të tretëve, përjashtuar shërbime të muajit dhjetor, pasi faturat e këtij muaji hartohen nga subjektet kontraktore në janar të vitit 2018.

Krahasimi i planit të miratuar nga KM, me shpenzimet e realizuara paraqitet në grafikun e mëposhtëm.



Fondet e pagave e shpërblimeve, sigurimeve shoqërore janë realizuar në nivelet respektivisht 80 dhe 60 përqind të fondit të planifikuar, si rezultat i mosplotësisht të të gjitha funksioneve në organike që në fillim të vitit sikurse janë planifikuar.

Fondi i planifikuar në zërin “Shërbime e furniturë” është realizuar në masën 65 përqind. Me këto fonde, pavarësisht nivelit të ulët të realizimit të planit, gjatë vitit janë siguruar kushtet e mjetet optimale të punës si dhe një bazë materiale logjistike e domosdoshme për përmbushjen e detyrave funksionale të Komisionit dhe gjithë stafit punonjës. Gjatë këtij viti, krahasimisht me vitin e kaluar, janë ulur ndjeshëm shpenzimet e këtij zëri. Kryesisht rezultojnë me ulje shpenzimet në artikujt shpenzime udhëtimi brenda , konsumi i karburantit, shpenzime të telefonisë fikse, shpenzime të ndryshme mirëmbajtjeje etj. Gjithashtu nisur nga sa më sipër, edhe në planin e vitit 2018, kemi planifikuar shpenzime të ulura, në zërin “Shërbime e furniturë”, krahasimisht me vitet e mëparshme.

Në zërin investime nga 790 000 lekë të planifikuara u shpenzuar vetëm 274 000 lekë. Diferenca e mbetur pa shpenzuar është rezultat i mbetjes nga prokurimi i rikonstruksionit të zyrave dhe mosrealizimi i një procedure prokurimi për mungesë të produktit në treg. Në mbyllje të vitit, gjendja e mjeteve financiare të disponueshme në llogarinë bankare të Entit, garanton plotësisht buxhetin e vitit 2018 të miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe teprica do të derdhet në buxhetin e shtetit.

Realizimi planit të shpenzimeve sipas katër mujorëve për vitin, për 4 zërat kryesore paraqitet si më poshtë në tabelën e mëposhtme:

**Tabela . Realizimi i planit të shpenzimeve për vitin 2017 sipas katër mujorëve.**

Nr.	Emërtimi i zërave të shpenzimeve	Plani Vjetor	Realizimi Janar -Prill	Realizimi Maj - Gusht	Realizimi Shtator - dhjetor
1	Fondi i pagave gjithsej	30 210 000	7 527 544	7 830 014	8 869 460
2	Sigurime shoqërore	5 145 000	989 604	841 018	1 171 218
3	Shërbime e furniturë	11 178 000	2 285 185	2 290 836	2 682 933
4	Investime	790 000			273 600
	<b>Totali</b>	<b>47,323,000</b>	<b>10,802,333</b>	<b>10,961,867</b>	<b>12,997,211</b>

Administrimi i vlerave materiale e monetare në ERRU kryhet në përputhje të plotë me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “ Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik” dhe Rregullores së brendshme të ERRU " Për menaxhimin e aktiveve